

VENDIM
Nr. 41, datë 22.12.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha,	kryetare
Marsida Xhaferllari,	anëtare
Fiona Papajorgji,	anëtare
Elsa Toska,	anëtare
Altin Binaj,	anëtar
Illir Toska,	anëtar
Sandër Beci,	anëtar

me sekretare Blerina Basha dhe Enina Kotoni, në datat 14.11.2022 dhe 1.12.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 3 (Z) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Zef Kovaçi, Franko Kovaçi, përfaqësuar me prokurë nga avokate Edlira Peku.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim nga Herald Jonuzaj dhe avokate e shtetit Irma Qosja.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar me autorizim nga avokatët e shtetit Abaz Deda, Irma Qosja dhe Juliana Pasho.

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONËS, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-2052, datë 16.12.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, vetëm për sa i përket sipërfaqes 990 m², ZK 8720, Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Pronës (ATP), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me kërkesën e datës 27.9.1995 kërkuësit Zef Kovaçi dhe Franko Kovaçi, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar Gj.K. (i ati i tyre), i janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) pranë Bashkisë Tiranë për njohjen, kthimin ose kompensimin e një sipërfaqeje toke truall prej 990 m². Me vendimin nr. 238, datë 27.9.1995, KKKP-ja pranë Bashkisë Tiranë ka vendosur njohjen ish-pronar të trashëgimlënësit të kërkuësve për këtë sipërfaqe dhe kompensimin me një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 7698, datë

15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (ligji nr. 7698/1993), për shkak se ky truall rezultonte i zënë me ndërtime shtetërore.

2. Në datat 1.9.2011, 6.8.2013 dhe 7.1.2015 kërkesit i janë drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) për kompensim në të holla sipas formularit përkatës, i nxjerrë në zbatim të VKM-ve nr. 192, datë 9.3.2011, nr. 599, datë 17.7.2013 dhe nr. 889, datë 17.12.2014 për përcaktimin e rregullave dhe kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit në të holla për vitet 2011, 2013 dhe 2014.

3. Rezulton, gjithashtu, sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), se me kërkesat e datave 26.10.2015 dhe 3.12.2015, kërkesit i janë drejtuar asaj për shkelje të neneve 6, pika 1 dhe 13 të KEDNJ-së, si dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të saj. GJEDNJ-ja, për shkak të objektit të ngjashëm, ka vendosur bashkimin e 191 kërkesave (ku bën pjesë edhe ajo e paraqitur nga kërkesit) dhe shqyrtimin e tyre në një vendim të vetëm. Me vendimin e datës 20.4.2021 të Seksionit të Tretë të GJEDNJ-së, në çështjen Ruci dhe Bejleri e të tjerë kundër Shqipërisë, këto kërkesa janë deklaruar të papranueshme, duke arsyetuar: “Në vitin 2012 Gjykata miratoi vendimin pilot në lidhje me këto çështje (Manushaqe Puto dhe të tjerë), në të cilin gjeti shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, si dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1, në lidhje me kohëzgjatjen e mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë që kanë njohur të drejtën e kompensimit, dhe shkelje të nenit 13 në lidhje me mungesën e mjeteve efektive të brendshëm. Për zbatimin e këtij vendimi pilot u miratua ligji i pronave i vitit 2015 që futi një mjet të ri kompensimi. Gjykata ka vlerësuar se mjeti i miratuar me ligjin e vitit 2015 është efektiv në kuptim të nenit 35 § 1 dhe nenit 13 të Konventës, për sa kohë kompensimi nuk do të ishte më i ulët se 10% e vlerës së pronës (shih Beshiri dhe të tjerë, § 215). Gjykata nuk gjen arsye të largohet nga ato gjetje në kontekstin e çështjes në shqyrtim dhe vlerëson se ankimet e aplikantëve sipas nenit 13 të Konventës janë baptazi të pabazuara dhe duhet të rrëzohen. Duke pasur parasysh gjetjet në vendimin Beshiri dhe të tjerë, i njëjti përfundim është i vlefshëm në lidhje me ankesat për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për zbatimin me efekt retroaktiv të ligjit të pronave të vitit 2015. Gjykata vlerëson se ky kërkim është gjithashtu baptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet. Në lidhje me ankimet sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata vëren se bazuar në fazën e procedurave në lidhje me secilin aplikim duhet të dallohen situatat e mëposhtme...”. Në lidhje me kërkesat e përfshira në tabelën 2 (ku përfshihen edhe ato të paraqitura nga kërkesit), GJEDNJ-ja është shprehur: “Procedurat e brendshme në lidhje me përcaktimin e shumës së kompensimit janë në pritje para gjykatave vendase. Ndaj për GJEDNJ-në do të ishte e parakohshme që të merrej me këto ankesa, të cilat duhet të rrëzohen sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës (shih Beshiri dhe të tjerë, § 219). Praktika e Gjykatës së Lartë ka rikonfirmuar se në rast se është paraqitur ankim në një gjykatë më të lartë, vendimi i gjykatës më të ulët do të bëhet përfundimtar dhe i zbatueshëm pas vendimit të Gjykatës së Lartë.”. (shih paragrafët 21-28 të vendimit të GJEDNJ-së).

4. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (ligji nr. 133/2015) dhe VKM-së nr. 223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (VKM nr. 223/2016), Agjencia e Trajtit të Pronave (ATP) ka proceduar me vlerësimin e pronës prej 990 m² të njohur ish-pronarit, duke e vlerësuar atë financiarisht në shumën 66,299,310 lekë, referuar çmimit 66,969 lekë për m², sikurse përcaktohet në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” (VKM nr. 89/2016). Ky vlerësim është publikuar në datën 8.5.2017 në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr. 14, Regjistri i vlerësimeve të vendimeve të vitit 1995. Rezulton se në VKM-në nr. 89/2016 nuk ka pasur ndryshim të zërit kadastral.

5. Duke mos qenë dakord me masën e kompensimit, kërkesit i janë drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me objekt: “Kundërshtimin e vlerësimit të njëanshëm financiar si antikushetues, në kundërshtim me parimet e së drejtës dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 dhe Protokollin nr. 1, neni 1, të KEDNJ-së, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Strasburg, të realizuar nga e paditura ATP-ja Tiranë për vendimin nr. 238, datë 27.9.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve

pranë Bashkisë Tiranë duke aplikuar kompensimin me vlerën e pasurisë së paluajtshme “truall” sipas vendimit nr. 1620, datë 26.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna” për shkak se kjo çështje është në proces shqyrtimi pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Strasburg, përpara datës së miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, VKM-së nr. 223/2016 dhe kërkesës së ATP-së nr. 4472, datë 4.5.2017 “Për publikim shtesë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të regjistrit të vendimeve, të cilat kanë njohur të drejtën për kompensim dhe vlerësimet për vitin 1995” botuar në Buletinin e Botimeve Zyrtare nr. 14, 8.5.2017.”. Kërkuesit kanë pretenduar se vlerësimi financiar i kryer nga ATP-ja është bërë duke iu referuar dispozitave antikushtetuese të ligjit nr. 133/2015 dhe ajo ka ndërhyrë në një vendim *quasi gjyqësor* të KKKP-së, duke mos aplikuar vlerën më të favorshme për të drejtën e tyre të fituar. Sipas tyre, ATP-ja duhej të kishte marrë parasysh vlerën e pronës në momentin e dhënies së vendimit për njohjen e së drejtës së kompensimit, sipas VKM-së 1620, datë 26.11.2008 për miratimin e çmimeve të trojeve në qarqe, sipas hartave përkatëse, (VKM nr. 1620/2008), ndërkohë që vlerësimi i kryer sipas VKM-së nr. 89/2016 është antikushtetues dhe jo ligjor.

6. Me vendimin nr. 109, datë 20.11.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Sipas saj, bazuar edhe në vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), që ia ka nënshtruar kontrollit të kushtetutshmërisë dispozitat e ligjit nr. 133/2015, edhe pse ky ligj ka parashikuar një mënyrë të re vlerësimi për kompensimin e pronave, që mund të rezultojë në një masë më të ulët kompensimi për ish-pronarët, ai plotëson kërkesat e proporcionalitetit të parashikuara në dispozitat kushtetuese dhe në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Kundër këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit kërkuesit kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-2052, datë 16.12.2021, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012) dhe se përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

8. Me kërkesën e datës 16.2.2021, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-2052, datë 16.12.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 27.6.2022 Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 13.7.2022 ka vendosur kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare publike.

10. Në datën 10.8.2022 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për shtimin e objektit të gjykimit, duke kërkuar edhe shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të VKM-së nr. 89/2016, vetëm për sa i përket sipërfaqes 990 m² të ZK 8720. Gjykata, bazuar në nenin 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 30, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, që parashikon se kërkuesi, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit, ka vendosur pranimin e kërkesës për shtimin e objektit. Po kështu, në vështrim të nenit 39, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka vendosur edhe thirrjen në këtë proces si subjekt të interesuar të Këshillit të Ministrave.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesit** kanë pretenduar se vendimi nr. 00-2021-2052, datë 16.12.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe VKM-ja nr. 89/2016 cenojnë këto të drejta kushtetuese:

11.1 *Për procesin gjyqësor:*

11.1.1 *Parimin e gjësë së gjykuar*, pasi Kolegji Administrativ në dhomë këshillimi ka revokuar një vendim të mëparshëm të Gjykatës së Lartë, i cili kishte vendosur shqyrtimin e rekursit të tyre në seancë gjyqësore. Vendimi i kalimit në seancë gjyqësore nuk është vendim i ndërmjetëm, por një vendim përfundimtar i fazës së parë të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, i një forme *sui generis*, i detyrueshëm për palët ndërgjyqëse, si dhe për gjykatën që ka dhënë vendimin.

11.1.2 *Të drejtën për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka kryer shpalljen për gjykimin në dhomë këshillimi për vendimin e revokimit, siç parashikojnë dispozitat procedurale, duke u mohuar kërkuësve të drejtën për të paraqitur pretendime mbi këtë seancë ekstra procedurale gjyqësore në dhomë këshillimi.

11.1.3 *Parimin e ndalimit të zbatimit me fuqi prapavepruese të ligjit procedural civil*, pasi Kolegji Administrativ ka revokuar vendimin për shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore, duke tejkaluar kompetencën ligjore për të vlerësuar pranueshmërinë e rekursit dhe duke marrë një kompetencë që ligji ia jepte Kolegjit Administrativ që kishte pranuar shqyrtimin e rekursit. Vendimi i revokimit është bazuar në nenin 171/b të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duke e konsideruar vendimin për shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore si vendim të ndërmjetëm, dispozitë e cila nuk parashikohej me ligj në kohën e shqyrtimit të rekursit. Vendimi i Kolegjit Administrativ që ka vendosur mospranimin e rekursit ka cenuar edhe *parimin e gjykatës së caktuar me ligj*, pasi ai nuk mund të vendoste mospranimin e rekursit në situatën që rekursi i kërkuësve kishte kaluar për gjykim në seancë gjyqësore me praninë e palëve nga një trup tjetër gjykuës i Gjykatës së Lartë.

11.1.4 *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi vendimi i revokimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore ka favorizuar subjektin e interesuar për të paraqitur parashtrime me shkrim në lidhje me rekursin, megjithëse ky subjekt nuk kishte paraqitur kundërrkurs. Po kështu, Kolegji Administrativ ka mbajtur standard të dyfishtë mes subjekteve të shpronësuar dhe ATP-së, pasi në rastet kur pranohet padia e subjektit të shpronësuar, vendimi nuk konsiderohet i formës së prerë, ndërsa kur ajo rrëzohet, vendimi konsiderohet i formës së prerë, duke i mohuar subjektit të shpronësuar një shkallë ankimi, në kundërshtim me nenin 13 të KEDNJ-së. Në këtë mënyrë, kërkuësit janë vendosur në kushte pabarazie me shtetas të tjerë, të cilëve iu është vendosur pranimi dhe shqyrtimi në seancë gjyqësore i rekurseve të paraqitura para ndryshimeve në ligjin nr. 49/2012.

11.1.5 *Parimin e paanshmërisë*, pasi Kolegji Administrativ që ka marrë vendim për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore është i njëjti që ka vendosur mospranimin e rekursit. Rrjedhimisht, trupi gjykuës e ka paragjykuar çështjen e kërkuësit.

11.1.6 *Parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka administruar prova dhe dokumente për vlerësimin financiar të realizuar në mënyrë të njëanshme nga ATP-ja, vlerësimin financiar konkret të zonës kadastrale, si dhe provën me ekspert, të cilat do u garantonin kërkuësve zhvillimin e debatit gjyqësor dhe të një hetimi të plotë për vlerën e truallit objekt gjykimi, pretendime që nuk janë trajtuar as nga Gjykata e Lartë. Për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, kërkuësve nuk u është dhënë mundësia të dëgjohen në seancë gjyqësore lidhur me shkaqet e parashtruara dhe për të debatuar për vlerësimin financiar të realizuar në mënyrë të njëanshme nga ATP-ja.

11.1.7 *Standardin e arsytimit të vendimit*, pasi vendimet gjyqësore të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural. Gjykata e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka vlerësuar nëse vlera financiare e ZK 8270 sipas VKM-së nr. 89/2016 ka respektuar ose jo metodologjinë e vlerësimit të pronës ose standardet ndërkombëtare të vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Ajo nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për mënyrën e zbatimit të kësaj metodologjie. Ky standard është cenuar edhe nga vendimi që ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi atij i mungon tërësisht analiza juridiko-ligjore, interpretimi i konfliktit në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të palëve. Po kështu, revokimi i vendimit të

kalimit të çështjes në seancë gjyqësore nuk është bërë me vendim, por vetëm me shpallje publike, në kundërshtim me legjislacionin përkatës.

11.1.8 *Parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës private*, pasi vendimi objekt kundërshtimi nuk ka respektuar jurisprudencën e mëparshme të GJEDNJ-së, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë për natyrën e vendimit të ish-KKKP-së dhe formën e tij *quasi gjyqësore*, që në këtë rast nuk është kundërshtuar nga asnjë person fizik ose juridik. Kolegji Administrativ nuk ka shqyrtuar pretendimet e ngritura në rekurs, që lidhen me faktin se nga zbatimi i së njëjtës metodologji, vlerësimi i pasurisë së kërkuesve është ulur në vlerën 50% në vitin 2016 në krahasim me vlerësimin e së njëjtës pasuri në vitin 2008 ose në vitin 2013.

11.1.9 *Interesin publik, parimet e shtetit social, të drejtësisë dhe të proporcionalitetit*, pasi shteti nuk mund të kujdeset vetëm për faturën financiare të buxhetit, por për të gjitha efektet e tjera të natyrës juridike, sociale dhe ekonomike të tij dhe të shtetasve. Po kështu, shteti nuk duhet të zgjedhë rrugën dhe metodën më të thjeshtë ose më të lehtë, por të bëjë përpjekje të realizojë *de facto* të drejtën e pronës së pronarëve të shpronësuar, duke garantuar ndërhyrje sa më të vogël në të drejtat kushtetuese. Midis shtetasve të shpronësuar dhe atyre që kanë ndërtuar në mënyrë informale është krijuar pabarazi në trajtim, pasi këta të fundit paguajnë një vlerë shumë më të ulët të vlerës së tokës mbi të cilën kanë ndërtuar.

11.2 *Për VKM-në nr. 89/2016:*

11.2.1 Kërkuesit legjitimohen për kundërshtimin e këtij akti, pasi vlerësimi financiar i ATP-së, sipas njoftimit, bazohet në përmbajtjen e tij dhe prej tij ka ardhur pasoja e kundërshtuar gjyqësisht.

11.2.2 Akti i kundërshtuar cenon të drejtën e pronës private, në aspektin e shpërblimit të drejtë, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Vlerësimi sipas VKM-së nr. 89/2016 nuk respekton standardet e parashikuara nga VKM-ja nr. 658, datë 26.9.2012 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”, si burimi i vetëm zyrtar për përlllogaritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme, standarde që respektohen duke aplikuar VKM-në nr. 187, datë 6.3.2013 “Për miratimin e vlerës së pronave për secilin qark në Republikën e Shqipërisë”. ATP-ja nuk provon me dokumente ligjore se ka zbatuar këtë metodologji në veprimtarinë përgatitore përpara miratimit të VKM-së nr. 89/2016, pasi nuk ekziston asnjë dokument vlerësimi financiar i pasurisë objekt gjykimi në vitin 2015 nga AKKP-ja, por ka një vlerësim pa një studim konkret. VKM-ja nr. 89/2016 nuk mbështetet në standardet e vlerësimeve ndërkombëtare të pasurive të paluajtshme të Shoqatës Evropiane të Vlerësuesve.

12. ***Subjekti i interesuar***, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar vetëm në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e VKM-së nr. 89/2016, si vijon:

12.1 Gjykata nuk ka juridiksion në çështjen konkrete, pasi ajo i përket kontrollit ligjor dhe jo atij të kushtetutshmërisë. Kërkuesit nuk kanë identifikuar mënyrën se si VKM-ja ka cenuar të drejtën kushtetuese të pronës private dhe shkaqet e parashtruara kanë të bëjnë me çështje “fakti”, pasi pretendohet padrejtësia e çmimit të referencës për zonën kadastrale ku përfshihet pasuria e tyre, me argumentin se nuk përputhet me çmimin real të tregut. Po kështu, kërkuesit nuk mund të kërkojnë shfuqizimin e VKM-së vetëm për sipërfaqen e tokës që iu takon, pasi kontrolli abstrakt shtrihet mbi normën në tërësi dhe sjell efekte për të gjitha rastet e ngjashme.

12.2 Kërkuesit nuk legjitimohen, pasi nuk kanë parashtruar argumente kushtetuese për lidhjen shkakësore ndërmjet kësaj VKM-je dhe pasojës negative të pretenduar. Ky kërkim, në mënyrën se si është formuluar, është i papranueshëm, pasi kontrolli abstrakt i aktit normativ nuk mund të shtrihet vetëm në zbatimin e një akti individual. Kërkuesit nuk i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion, pasi ata duhet të kishin kundërshtuar aktin e vlerësimit financiar dhe më pas u lindte e drejta për të kundërshtuar VKM-në objekt shqyrtimi. Po kështu, pretendimet e ngritura janë të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese dhe nuk janë evidentuar pasojat në drejtim të shkeljes së të drejtave kushtetuese. Kërkuesit nuk legjitimohen as *ratione temporis*, pasi ata kanë marrë dijeni për

VKM-në në vitin 2017, kur i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, për rrjedhojë janë tej afatit ligjor për kundërshtimin e këtij akti.

12.3 Në lidhje me themelin e çështjes, skema e re e procesit të kthimit të kompensimit të pronave është marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ-ja, të cilat kanë arritur në përfundime të njëjta, se shpërblimi për ish-pronarët nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë, ndërkohë që ndërhyrjet ligjore kanë synuar përfundimin e këtij procesi në mënyrë të drejtë. Për skemën e re të kthimit dhe kompensimit GJEDNJ-ja, në vendimet *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë* dhe *Ruci dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, i ka vlerësuar kërkesat për çështje të kthimit dhe kompensimit të pronave si të papranueshme, duke përcaktuar vetëm një kufi prej 10% që duhet të respektohet ndërmjet vlerësimit sipas zërit kadastral të sotëm dhe zërit kadastral të kohës së shpronësimit.

13. **Subjekti i interesuar**, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar sa vijon:

13.1 Pretendimet që lidhen me vendimin e revokimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore janë haptazi të pabazuara dhe të mbështetura në supozime, duke mos iu referuar akteve të dosjes gjyqësore. Këto pretendime të kërkuarve përbëjnë një kërkesë abuzive, në shtrembërim të fakteve dhe të rrethanave të çështjes. Pretendimet për cenimin e parimeve të gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, të barazisë së armëve dhe të paanshmërisë si rezultat i vendimit të revokimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, janë haptazi të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë asnjëherë një vendim të tillë.

13.2. Pretendimet për cenimin e së drejtës së pronës dhe parimit të sigurisë juridike janë të pabazuara, pasi për skemën e re të kompensimit sipas ligjit nr. 135/2015, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, ka vlerësuar se metodologjia dhe formula e parashikuar, pavarësisht se ndërhyjnë në të drejtën e pronës private, respektojnë elementet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës për sa i përket proporcionalitetit të ndërhyrjes. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni i Venecias, si dhe GJEDNJ-ja në vendimin *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, ku ka vlerësuar se referenca në zërin kadastral fillestar të pronave të shpronësuara, si bazë për kryerjen e vlerësimit financiar, nuk është *per se* arbitrare, duke vendosur në përfundim një tavan 10% për diferencën që mund të ekzistojë midis vlerësimit sipas zërit kadastral të sotëm dhe atij të kohës së shpronësimit. Ky vendim është pasuar nga vendimi *Ruci dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, ku GJEDNJ-ja ka vlerësuar si të papranueshme të gjitha kërkesat e paraqitura pranë saj për çështje të kthimit dhe kompensimit të pronave.

14. **Subjekti i interesuar, ATP-ja**, nuk ka paraqitur parashtrime pranë kësaj Gjykate, edhe pse është njoftuar rregullisht për gjykimin.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarve

15. Sipas kërkuarve ata legjitimohen për pretendimet e tyre në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, pasi kanë qenë palë në atë gjykim në përfundim të të cilit është dhënë vendimi objekt kundërshtimi. Ata pretendojnë se legjitimohen edhe për kundërshtimin e VKM-së nr. 86/2016, pasi vlerësimi financiar i ATP-së, sipas njoftimit, bazohet në përmbajtjen e këtij akti, për rrjedhojë ai ka sjellë pasojat e kundërshtuara gjyqësisht.

16. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, kërkuarët nuk legjitimohen për kundërshtimin e VKM-së nr. 89/2016, pasi në thelb pretendimet e tyre janë me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese dhe ata nuk kanë parashtruar argumente për lidhjen shkakësore ndërmjet këtij akti dhe pasojës negative të pretenduar. Kërkuarët nuk kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion, pasi ata duhej të kishin kundërshtuar aktin e vlerësimit financiar dhe më pas u lindte e drejta për të kundërshtuar VKM-në. Ata nuk legjitimohen as *ratione temporis*, pasi kanë marrë dijeni për

VKM-në në vitin 2017, kur i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, për rrjedhojë janë tej afatit ligjor për kundërshtimin e saj.

17. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

18. Ndërsa në lidhje me aktin normativ, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 31, datë 31.4.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

19. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohen *ratione personae*, pasi kanë qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, në të cilin është zbatuar edhe VKM-ja nr. 89/2016, për rrjedhojë janë bartës të së drejtës së pronës private dhe asaj për proces të rregullt, të pretenduara të cenuara, pra provojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

20. Për sa i takon kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, individ i mund t’i drejtohet Gjykatës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Ndërsa në lidhje me ankimin kushtetues individual me objekt kundërshtimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit ose aktit normativ, Gjykata ka theksuar se, si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individ duhet, së pari, t’i kundërshtojë ato në gjykatat kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuesi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislacioni nuk parashikon mjete juridike ose ato janë joefektive). Meqenëse mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (shih vendimet nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 31, datë 4.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Gjykata vëren se kërkuesi kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka administruar prova dhe dokumente për vlerësimin financiar të realizuar në mënyrë të njëanshme nga ATP-ja, vlerësimin financiar konkret të zonës kadastrale dhe provën me ekspert, çka do të garantonte një proces të rregullt ligjor. Gjykata, referuar përmbajtjes së rekursit dhe parashtrimeve të paraqitura në Gjykatën e Lartë, konstaton se një pretendim i tillë nuk është ngritur në rekurs, por në parashtrimet e datës 2.12.2021 drejtuar Gjykatës së Lartë, pas njoftimit të datës për zhvillimin e seancës gjyqësore. Gjykata vëren se, sipas nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 49/2012: “Gjyqtari relator përgatit relacionin, duke

pasqyruar në të, veç të tjerave, edhe përmbajtjen e vendimit të ankimit, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, prapësimet e paraqitura në kundërrekurs, shqyrtimin e fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.”. Për rrjedhojë, për sa kohë që këto pretendime nuk janë ngritur nga kërkuesit në rekurs, duke mos u bërë objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit nga Gjykata e Lartë, ato nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë, pasi konsiderohet se në lidhje me to kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive. Kurse për sa u përket pretendimeve të tjera në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë kërkuesit nuk kanë asnjë mjet tjetër ankimi përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

23. Për sa i përket kërimit në objektin e kërkesës që ka të bëjë me VKM-në nr. 89/2016, rezulton se kërkuesit kanë kundërshtuar në gjykatat e zakonshme aktin e vlerësimit të ATP-së, duke pretenduar se, bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, vlerësimi financiar duhej bërë sipas çmimeve të tokës të përcaktuara me VKM-në nr. 1620/2008.

24. Gjykata vlerëson se edhe pse kërkuesit kanë pretenduar përgjatë proceseve gjyqësore se vlerësimi i pronës së njohur për kompensim nuk duhej të bëhej në bazë të VKM-së nr. 89/2016, por në përputhje me metodologjinë dhe vlerën e tokës të përcaktuara me VKM-në nr. 1620/2008, në thelb pretendimet e tyre kanë të bëjnë me mungesën e një vlerësimi real dhe të drejtë të pronës nga ky akt nënligjor, çka ka çuar në një vlerësim të njëanshëm dhe jokushtetues, në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës që garanton të drejtën e pronës private dhe shpërblimin e drejtë. Për rrjedhojë, konsiderohet se kërkuesit i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion edhe në lidhje me kundërshtimin e VKM-së nr. 89/2016. Po kështu, ata kanë kundërshtuar në gjykatat e zakonshme aktin individual të vlerësimit të nxjerrë nga ATP-ja, gjykim gjatë të cilit kanë ngritur edhe pretendimet për antikushtetutshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore ku është bazuar ai. Për rrjedhojë, ata i kanë shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë përpara se t'i drejtohen Gjykatës me ankim kushtetues individual.

25. Kërkuesit legjitimohen *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor ndaj tyre, është i datës 16.12.2021, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 14.4.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

26. Në lidhje me VKM-në nr. 89/2016, përveç afatit të parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, në nenin 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Pra, në rastin e ankimit kushtetues individual konstatimi i cenimit, si rregull, nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ, por ai llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ. Kërkuesit e kanë kundërshtuar VKM-në nr. 89/2016 së bashku me vendimet gjyqësore që kanë shqyrtuar pretendimet për vlerësimin financiar individual të bërë në zbatim të ligjit nr. 133/2015 dhe të kësaj VKM-je, ndaj afati 4-mujor llogaritet nga data e vendimit të fundit gjyqësor që është dhënë bazuar mbi këtë akt, ai i Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, kërkuesit legjitimohen *ratione temporis* edhe për kundërshtimin e aktit nënligjor.

27. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesit kanë ngritur pretendime në lidhje me vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, ashtu edhe për vendimin e Kolegjit Administrativ që ka vendosur mospranimin e rekursit kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Në lidhje me vendimin e revokimit, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe të parimeve të gjësë së gjykuar, gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj, moszbatimit me fuqi prapavepruese të ligjit procedural civil, barazisë para ligjit, si dhe të paanshmërisë në gjykim.

28. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata, duke iu referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, konstaton se rekursi i kërkuesve është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 7.2.2018, datë në të cilën është caktuar edhe gjyqtari

relator. Me ndryshimin e përbërjes së Gjykatës së Lartë, në datën 24.11.2021 është caktuar gjyqtari i ri relator dhe me vendimin e datës 16.12.2021 është caktuar shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi. Po në këtë datë, Gjykata e Lartë rezulton të ketë shpallur një listë të çështjeve administrative për shqyrtim në dhomë këshillimi, në të cilën vërehet shënimi “*të revokuara*”, pra që i përket revokimit të vendimeve të ndërmjetme të asaj gjykate me të cilat ishte vendosur shqyrtimi i këtyre çështjeve në seancë gjyqësore. Në këtë listë rezulton të jetë edhe çështja e kërkuësve. Nga komunikimi me shkresë i Gjykatës me Gjykatën e Lartë, kjo e fundit është shprehur se nga verifikimi në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve të kësaj gjykate, nuk rezulton që çështja e kërkuësve të jetë shqyrtuar më parë në dhomën e këshillimit dhe as të jetë vendosur “kalimi i çështjes në seancë gjyqësore”, gjë e cila vërtetohet edhe nga inventari i dosjes gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Kërkuësit, edhe pse kanë kundërshtuar këtë vendim revokimi, duke parashtruar në lidhje me të pjesën më të madhe të pretendimeve për cenim të së drejtës për proces të rregullt, nuk kanë paraqitur bashkëlidhur kërkesës kopje të vendimit të ndërmjetëm që kundërshtojnë. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se në aktin “Lista e çështjeve për shqyrtim” ka një gabim material të shfaqur në formën e shënimit “*të revokuara*”, pasi për kërkuësit nuk ka pasur më parë një vendim të tillë të ndërmjetëm, por shqyrtimi i çështjes së tyre është bërë për herë të parë në datën 16.12.2021, kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e tij.

29. Gjykata ka theksuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, këto pretendime të kërkuësve janë haptazi të pabazuara.

30. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, në lidhje me procesin e zhvilluar nga Kolegji Administrativ që ka vendosur mospranimin e rekursit, kërkuësit kanë pretenduar, mes të tjerash, cenimin e parimit të barazisë para ligjit, pasi është mbajtur standard i dyfishtë mes subjekteve të shpronësuar dhe ATP-së. Kjo sepse në rastet kur është pranuar padia e subjektit të shpronësuar, vendimi nuk konsiderohet i formës së prerë, ndërsa kur është rrëzuar padia, vendimi konsiderohet i formës së prerë, duke iu mohuar kështu subjektit të shpronësuar *apriori* një shkallë ankimi, në kundërshtim me nenin 13 të KEDNJ-së, duke e vendosur në kushte pabarazie me ata shtetas që iu është vendosur pranimi dhe shqyrtimi në seancë gjyqësore i rekurseve të paraqitura para ndryshimeve në ligjin nr. 49/2012. Gjykata vëren se këto pretendime të kërkuësve lidhen, në thelb, me përmbajtjen e normave ligjore që kanë përcaktuar juridiksionin gjyqësor për shqyrtimin e këtyre lloj çështjesh, si edhe rregullat procedurale të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Kërkuësit nuk kanë arritur t'i ngrenë këto pretendime në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojnë se cenimi i pretenduar i të drejtave të tyre kushtetuese është rezultat i procesit gjyqësor dhe vendimmarrjes gjyqësore të kundërshtuar. Po kështu, pretendimet lidhur me mënyrën e vlerësimit të provave dhe të zbatimit të dispozitave të ligjit material dhe atij procedural, si edhe mosrespektimin e vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

31. Gjykata vëren se kërkuësit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, duke e lidhur atë me procesin e revokimit në Gjykatën e Lartë, edhe pse për kërkuësit, siç u konstatua më sipër, nuk ka pasur një të tillë në atë gjykatë. Megjithatë, në thelb ata e kanë lidhur këtë pretendim me mosshqyrtimin e çështjes së tyre në seancë gjyqësore, por në dhomën e këshillimit, duke mos iu dhënë mundësi të debatonin mbi provat dhe vlerësimin financiar të ATP-së. Për rrjedhojë, ky pretendim, ashtu edhe pretendimet e tjera të kërkuësve në lidhje me procesin gjyqësor, konkretisht ato për cenimin e parimeve të arsyetimit të vendimit dhe të sigurisë juridike e të së drejtës së pronës private, duke qenë pretendime me natyrë kushtetuese,

përfshihen në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë në vijim do të analizohet bazueshmëria e tyre në themel.

32. Në lidhje me pretendimet e kërkuësve për kundërshtimin e VKM-së nr. 89/2016, Gjykata vëren se kërkuësit si gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme, ashtu edhe në kërkesën në shqyrtim kanë pretenduar se vlerësimi i pronës së tyre në bazë të ligjit nr. 133/2015 dhe VKM-së nr. 89/2016 ka sjellë një vlerësim antikushtetues dhe jo ligjor, i cili nuk përbën një shpërblim të drejtë. Sipas tyre, vlerësimi i pronës së njohur për kompensim nuk duhej të bëhej në bazë të VKM-së nr. 89/2016, por duhej të zbatohet metodologjia dhe vlera e përcaktuar me VKM-në nr. 1620/2008, që është akti normativ i cili duhej të rregullonte çështjen në shqyrtim. Po kështu, Gjykata vëren se edhe pretendimet për cenimin e interesit publik dhe parimeve të shtetit social, të drejtësisë dhe proporcionalitetit, kërkuësit i kanë ngritur në drejtim të VKM-së nr. 89/2016 dhe mënyrës se si ajo ka përcaktuar hartën e vlerave të tokës.

33. Gjykata rithekson se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 7, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore, raste në të cilat Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Edhe GJEDNJ-ja është shprehur se gjykatat kombëtare kanë detyrë parësore të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit dhe se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e tyre në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale. Megjithatë, edhe pse roli i GJEDNJ-së mund të jetë i kufizuar në kuptimin e vlerësimit dhe interpretimit të ligjit të brendshëm, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë kombëtare ka zbatuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast konkret, i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” dhe/ose me mohim të së drejtës, pra kur vendimet e gjykatave janë dukshëm arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Anheuser-Busch Inc. Kundër Portugalisë, datë 11 janar 2007 § 83; Kuznetsov dhe të tjerë kundër Rusisë, datë 11 janar 2007, §§ 70, 74, 84*).

35. Në vështrim të sa më sipër, duke qenë se në thelb kërkuësit kanë pretenduar se vlera e pronës e përcaktuar sipas kësaj VKM-je nuk është në përputhje me konceptin “shpërblim i drejtë”, të gjitha pretendimet e parashtruara në kërkesë që kanë të bëjnë me zbatimin dhe përmbajtjen e aktit nënligjor do të trajtohen në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën kushtetuese të pronës private.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit

36. Sipas kërkuësve, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë mundësinë të dëgjohen në seancë gjyqësore lidhur me shkaqet e parashtruara prej tyre në rekurs, por e ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit.

37. Gjykata vëren se parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit t’u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njërës palë do të

prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Duke e vlerësuar procesin gjyqësor të zhvilluar për çështjen e kërkuar në tërësinë e tij, Gjykata vëren se gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit kërkuar janë përfaqësuar nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, duke u dëgjuar e parashtruar pretendimet dhe kërkimet e tyre. Në vijim, kërkuar kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs, ku kanë parashtruar kundërshtitë e tyre në lidhje me atë vendimarrje. Po kështu, pretendimet e kërkuar, në këndvështrim të respektimit të këtij parimi, i referohen vetëm procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë dhe kanë të bëjnë me faktin se ai gjykim është zhvilluar në dhomën e këshillimit, ndërkohë që ata nuk kanë ngritur pretendime për mungesën e njoftimit ose mos marrjen dijeni për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit.

39. Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, ligji procedural zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum*. Në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 3, datë 11.2.2021; nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Referuar parashikimeve të dispozitave procedurale të ligjit nr. 49/2012, që rregullojnë procedurën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, pikat 1 dhe 2 të nenit 61 parashikojnë se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, kurse neni 62 ka përcaktuar rastet kur gjykata vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe procedurën që ndiqet në një rast të tillë.

40. Gjykata vlerëson se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, *nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse*. Për rrjedhojë, në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për shqyrtimin e rekursit dhe njoftimin e palëve, vetëm fakti që ky gjykim është zhvilluar në dhomën e këshillimit nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt.

41. Për sa më sipër, nuk rezulton që kërkuar të jenë vendosur në pozita të pabarabarta me subjektin e interesuar, për rrjedhojë ky pretendim është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

42. Kërkuar kanë pretenduar se është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit, i mungon tërësisht analiza juridiko-ligjore, interpretimi i konfliktit në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të palëve.

43. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i

cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 23 datë 10.10.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Duke verifikuar respektimin e këtyre standardeve në çështjen konkrete, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe u ka dhënë përgjigje kërkuarve se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, të cilat do ta bënë të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Në vijim, bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së për çështjet e kompensimit të pronave, ajo ka arritur në konkluzionin se gjykata e apelit ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes dhe se ka sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me të (*shih paragrafët 15-16 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

46. Vendimi i Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, vendimarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit, pretendimet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese, ku ajo u jep përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs. Edhe pse me një arsyetim të kufizuar, Gjykata e Lartë ka përmbushur standardet e mësipërme të arsyetimit të vendimit të dhomës së kështillimit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.3. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës private

47. Kërkuarve kanë pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi vendimi objekt kundërshtimi nuk ka respektuar jurisprudencën e mëparshme të GJEDNJ-së, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë për natyrën e vendimit të KKKP-së dhe formën e tij *quasi gjyqësore*, duke qenë se ky vendim nuk është kundërshtuar nga asnjë person fizik ose juridik. Po kështu, ata kanë pretenduar cenimin e së drejtës së pronës, për shkak se vlerësimi financiar i kryer nga ATP-ja është kryer duke iu referuar dispozitave të ligjit nr. 133/2015 dhe të VKM-së nr. 89/2016, duke mos aplikuar vlerën më të favorshme për këtë të drejtë të fituar, ndërkohë që vlera e pronës duhej të ishte përcaktuar sipas VKM-në nr. 1620/2008, që është më e favorshme për kërkuarve. Sipas tyre, nga zbatimi i kësaj metodologjie, vlerësimi i pasurisë së kërkuarve është ulur në vlerën 50% në vitin 2016, në krahasim me vlerësimin e së njëjtës pasuri në vitin 2008 ose 2013.

48. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se skema e re e procesit të kthimit të kompensimit të pronave është marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ-ja, të cilat kanë arritur në përfundime të njëjta se shpërblimi për ish-pronarët nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë dhe se ndërhyrjet ligjore synojnë pikërisht përfundimin e këtij procesi në mënyrë të drejtë. GJEDNJ-ja ka përcaktuar vetëm një kufi prej 10% që duhet të respektohet ndërmjet vlerësimit sipas zërit kadastral të sotëm dhe zërit kadastral të kohës së shpronësimit.

49. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

50. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar lidhja që siguria juridike ka me të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 50, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të ankesave individuale kushtetuese, Gjykata e ka analizuar sigurinë juridike, të lidhur edhe me pretendimet për mosrespektimin e vendimeve të kësaj Gjykate nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 10, datë 4.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Për sa i përket së drejtës së pronës private, neni 41 i Kushtetutës parashikon jo vetëm që kjo e drejtë është e garantuar (pika 1), por edhe se ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e saj vetëm për interesa publike (pika 3), të cilët lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (pika 4), ndërkohë që për masën e këtij shpërblimi mund të bëhet ankim në gjykatë (pika 5). Në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i së drejtës së pronës. Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kriterëve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe kufizimet e pronës. Për sa i përket konceptit të shpërblimit të drejtë, Gjykata e ka interpretuar të lidhur me konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik, si dhe respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social. Ajo ka vlerësuar se e drejta e pronës, në kuptimin që i jep neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nuk mund të barazohet me kuptimin që ka në vetvete e drejta dhe se e drejta e pronës nuk njehet me të drejtën e kthimit të saj. Referuar kriterit kushtetues të “shpërblimit të drejtë”, Gjykata ka theksuar se shpërblimi ose kompensimi në dobi të subjektit të shpronësuar nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 30, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Në lidhje me parashikimet e ligjit nr. 133/2015 dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, Gjykata ka vlerësuar pajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitave që lidheshin me vlerën e kompensimit të pronave. Në vendimin e parë të saj nr. 1, datë 16.1.2017, edhe pse ka vendosur shfuqizimin e pikave 3 dhe 5 të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015, pasi cenonin parimin e sigurisë juridike, për sa i takon skemës së rivlerësimit për pronat e tjera, Gjykata është shprehur se metodologjia dhe formula e parashikuar nga ligji nr. 133/2015 ndërhyjnë në të drejtën e pronës private, por kjo ndërhyrje respekton elementet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Në vlerësimin e Gjykatës skema e re e kompensimit ka ndryshuar metodën e vlerësimit, e cila mund të rezultojë në një masë kompensimi më të ulët se sa ajo e parashikuar nga ligjet e mëparshme, të cilat kishin krijuar pritshmëri për marrjen e kompensimeve sipas vlerës së tregut të pronës në momentin e nxjerrjes së vendimit për kompensimin. Ndonëse masa më e ulët e kompensimit nuk mund të cilësohet si “shpronësim formal”, ajo mund të cilësohet si një “ndërhyrje tjetër”, e cila, pavarësisht se mund të rezultojë në një masë më të ulët kompensimi për subjektet e shpronësuara, në tërësinë e saj respekton proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e kompensimit të pronës së tyre dhe, si e tillë, është në respektim të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

54. Për sa i takon skemës së kompensimit sipas kuadrit të ri ligjor, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kur vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit të dhënë më parë janë pa vlerë të përcaktuar, me qëllim që të parandalohet një barrë e tepërt për subjektet e shpronësuara, mjeti juridik mund të konsiderohet efektiv nëse shuma totale e kompensimit, pavarësisht formës së kompensimit, arrin të paktën 10% të vlerës që do të ishte përfituar nëse vlerësimi financiar do të

ishite kryer duke përdorur si referencë zërin kadastral aktual të pronës së shpronësuar (*shih vendimin Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 17.3.2020, paragrafi 196*).

55. Në lidhje me hartat e vlerësimit të vitit 2016, GJEDNJ-ja e ka konsideruar të pasaktë parashtrimin në lidhje me uljen drastike të çmimit të referencës dhe ka vërejtur se ky çmim për të njëjtën kategori kadastrale është rritur krahasuar me atë të supozuar në vitin 2014. Sipas saj, ish-ankuesit e suksesshëm në atë gjykatë kanë marrë kompensim (në vlerën e tregut) që ishte në përputhje me legjislacionin në fuqi në kohën materiale. Nëse hartat e vlerësimit të pronave të vitit 2016 pasqyrojnë vlera të sakta të pronës është një çështje fakti që duhet të përcaktohet përfundimisht nga autoritetet kombëtare (*po aty, paragrafët 197-199 të vendimit*).

56. Në vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, objekt i të cilit kanë qenë sërish dispozitat e ligjit nr. 133/2015 dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, Gjykata ka vlerësuar se sistemi aktual i vlerësimit të pronës nuk respekton në të gjitha rastet pragun minimal prej 10% të vlerësimit financiar dhe, për këtë arsye, është një ndërhyrje jo proporcionale në të drejtën e pronës private. Në vlerësimin e Gjykatës kufizimi i së drejtës së pronës private ka ardhur edhe si pasojë e mungesës së rregullimit nga pika 2 e nenit 7 të ligjit nr. 133/2015 të situatës të ndryshimit që ka pësuar zëri kadastral i pronës ndër vite, çka përbën një boshllëk ligjor nga i cili vijnë pasoja negative për të drejtat kushtetuese të individëve, në rastin konkret e drejta e pronës private. Kjo mungesë e rregullimit ligjor të situatës, që ka rezultuar nga ndryshimi i zërit kadastral, i ka mohuar kompensimin e drejtë kësaj kategorie subjektsh.

57. Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj garantohet nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj (*shih vendimin nr. 17, datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

58. Po ashtu, Gjykata rithekson detyrimin e shtetit shqiptar për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare mbështetur në nenin 5 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar, në përputhje me angazhimin që Republika e Shqipërisë, si shtet anëtar i Këshillit të Evropës, ka ndërmarrë sipas nenit 46, pika 1, të KEDNJ-së, që parashikon se palët e larta kontraktuese zotohen t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës Evropiane në mosmarrëveshjet në të cilat janë palë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Bazuar në rrethanat konkrete të çështjes në shqyrtim, me vendimin nr. 238, datë 27.9.1995 të KKKP-së pranë Bashkisë Tiranë trashëgimlënësi i kërkuesve është njohur ish-pronar mbi një sipërfaqe toke truall prej 990 m², dhe është vendosur kompensimi me një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr. 7698/1993, pasi trualli rezultonte i zënë me ndërtime. Në vitet 2011, 2013 dhe 2015 kërkuesit i janë drejtuar me kërkesë për kompensim AKKP-së sipas formularit përkatës, të nxjerrë në zbatim të akteve nënligjore. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ATP-ja ka proceduar me vlerësimin e pronës prej 990 m² të njohur ish-pronarit, duke e vlerësuar atë financiarisht në shumën 66,299,310 lekë, referuar çmimit për m² të përcaktuar në VKM-në nr. 89/2016. Në nenin 3 të ligjit nr. 133/2015 është përcaktuar fusha e zbatimit, si dhe shtrirja e efekteve, për sa i takon vlerësimit financiar, për ekzekutimin e të gjitha vendimeve që nuk janë zbatuar për njohjen e së drejtës së kompensimit, të dhëna nga organet administrative ose gjyqësore.

60. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nga shqyrtimi në tërësi i kësaj çështjeje nuk konstatohet ulje drastike e çmimit të referencës për sipërfaqen e truallit që iu është kompensuar kërkuessve. Vlerësimi i pronës së tyre rezulton të jetë bërë nga ATP-ja në përputhje me parashikimet dhe procedurat e ligjit nr. 133/2015 dhe sipas vlerës për m² që parashikonte akti nënligjor në fuqi në kohën e kryerjes së këtij vlerësimi, për rrjedhojë kërkuessit rezulton të kenë marrë kompensim financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi në kohën materiale. Nga kërkuessit nuk u provua nga pikëpamja faktike që harta e vlerësimit të pronave, sipas VKM-së në fjalë, të mos pasqyrojë vlera të sakta të pronës, ndërkohë që pretendimet e tyre në këtë drejtim kanë natyrë të përgjithshme. Ata janë përpjekur t'ia kalojnë barrën e provës ATP-së, duke parashtruar se ky organ nuk provon me dokumente ligjore se ka zbatuar standardet e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk ekziston asnjë dokument vlerësimi financiar i pasurisë objekt gjykimi në vitin 2015 nga AKKP-ja, ndërkohë që vlerësimi është bërë pa pasur një studim konkret, dhe se VKM-ja nr. 89/2016 nuk mbështetet në standardet e vlerësimeve ndërkombëtare të pasurive të paluajtshme të Shoqatës Evropiane të Vlerësuesve. Gjykata vëren se edhe vetë gjykatat e zakonshme, të cilat kanë shqyrtuar çështjen nga pikëpamja e ligjit dhe e fakteve, nuk kanë arritur në një përfundim të tillë. Gjykata rithekson se kriteri kushtetues është ai i shpërblimit të drejtë dhe jo i shpërblimit të plotë të pronës së njohur për kompensim, plotësimi i të cilit nuk vihet në dyshim nga zbatimi i VKM-së nr. 89/2016.

61. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, është i pabazuar.

62. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuessve duhet të rrëzohet, sipas arsyetimit të mësipërm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 22.12.2022.

Shpallur, më 3.2.2023.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Altin Binaj, Elsa Toska, Sandër Beci, Ilir Toska